

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar, Agim Maliqi dhe Nebojsa Boriçiç, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit Sh.H., për shkak të veprës penale rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes nga neni 256 par.1 lidhur me nenin 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës KPK-së, duke vendosur për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit av. B.T., kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda P.nr.28/2015 të datës 03.05.2016 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.562/2016 të datës 25.11.2016, në seancën e kolegjit, të mbajtur me 22.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit Sh.H., e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë- Departamenti për Krime të Rënda P.nr.28/2015 të datës 03.05.2016 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.562/2016 të datës 25.11.2016.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë- Departamenti për Krime të Rënda P.nr.28/2015 të datës 03.05.2016, i dënuari Sh.H., është shpallur fajtor, për veprën penale rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes nga neni 256 par.1 lidhur me nenin 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës KPK-së dhe është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 01.02.2011 deri me datë 28.07.2011. Është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 25 (njëzet e pesë) € dhe shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 30 (tridhjetë) €, kurse të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.562/2016 të datës 25.11.2016, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe mbrojtësit të të dënuarit, kurse aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.562/2016 të datës 25.11.2016, e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër aktgjytimeve të Gjykatës Themelore në Pejë dhe Gjykatës së Apelit të Kosovës, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit Sh.H., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuar të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.nr.170/2017 e datës 21.09.2017, ka propozuar që, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë nuk i ka përfillë sugjerimet e Gjykatës Supreme të Kosovës sipas aktvendimit AP.nr.403/2012 të datës 22.11.2012, që janë të theksuara lidhur me dëgjimin e dëshmitarëve T.D. dhe Gj.U., rreth kohës së qëndrimit në restorantin "O." të të dënuarit, kurse leximi i dëshmimeve të dëshmitarëve T.D. dhe Gj.U., konsiderohen prova në të cilat nuk mund të mbështetet aktgjykimi i shkallës së parë. Më tutje pretendohet, në pasaktësinë e identifikimit të cilën e ka bërë dëshmitarja F.H., për të dënuarin dhe theksohet se dëshmitarja është sugjeruar nga ana e policisë në fotografinë me nr.8 që është fotografia e të dënuarit e me këtë identifikimi është provë e papranueshme e gjithashtu identifikimi nuk është i mjaftueshëm për t'u bazuar në të.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, janë të pabazuara, meqë aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Gjykata e shkallës së parë, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës penale dhe nuk qëndron pretendimi se nuk është vepruar sipas aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP.nr.403/2012 të datës 22.11.2012, meqë dëshmitarët T.D. dhe Gj.U., konfirmohet se jetojnë në Zvicër dhe e kanë njoftuar gjykatën e shkallës së parë, se nuk kanë mundësi që të paraqiten në shqyrtimin gjyqësor, mirëpo deklaratimet e tyre i kanë bërë në zyrën noteriale në Zvicër dhe kanë pohuar se me datë 01.02.2011 në ora 17:30-18:30, kanë shkuar në restorant dhe në tavolinë prezent ka qenë vetëm U.D. dhe A.N. dhe asnjë person tjetër, që përjashtojnë faktin se në tavolinë ishte edhe i dënuari. Megjithatë, udhëzimet e aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP.nr.403/2012 të datës 22.11.2012, kanë kërkuar precizimin e kohës së saktë të daljes dhe kthimit në restorantin "O." të të dënuarit, ashtu që dëshmitarët U.D. dhe A.N., kanë theksuar faktin se i dënuari kur ka shkuar të bëj ndërrimin e gomave është vonuar rreth një orë. Kurse edhe më i saktë ka qenë dëshmitari tjetër P.M., i cili sipas aktgjykimit të shkallës së parë faqe 5, ka konfirmuar deklarinimin e tij gjatë procedurës hetimore se "*... Sh., ka dal rreth orës 17:30, ka shkuar diku dhe është kthyer pas 40 minutash...*" e që është kohë që i përgjigjet kohës së kryerjes së veprës penale sipas dispozitivit të aktgjykimit "*...me datë 01.02.2011, rreth orës 18:00*".

Përkitazi me saktësinë e identifikimit dhe faktin se dëshmitarja F. H. është sugjeruar nga ana e policit hetues, për ta identifikuar të dënuarin, ky pretendim nuk është i qëndrueshëm, së pari për faktin se në asnjë shkresë nuk rezulton se ka ndodhur ky sugjerim siç pretendohet nga mbrojtësi i të dënuarit, e po ashtu dëshmitarja F.H., me saktësi të madhe ka përshkruar konstruktin fizik të të dënuarit dhe veshjen e tij që nga deklarimi i saj i parë dhe atë gjatë kohës deri sa trajtohej në spital nga lëndimet e pësuar, për më tepër përshkrimi i bërë "*...kishte të veshur një palë farmerka të qelta dhe këpuca në formë patikash të zeza dhe*

të cilat kanë qenë të vizlluara me sa duket të llakit..”, e i cili përshkrim ishte i njëjtë me veshjet e tij menjëherë pas ndalimit të tij sikurse shihet në fotografitë e të dënuarit që gjenden në shkresat e lëndës. Se identifikimi ishte i saktë tregon edhe fakti se dëshmitarja pos përshkrimit të të dënuarit, pohoi se personi që e kishte sulmuar ishte kushëriri i saj Sh., që tregon se bëhet fjalë për identifikim të saktë dhe kjo bazuar në faktin se me të dënuarin ishin kushërinj dhe jetonin në afërsi me njëri-tjetrin. Dëshmitarja po ashtu kishte dhënë sqarime edhe për faktin se cila ishte arsyeja që nuk kishte përmendur emrin e të dënuarit gjatë kohës kur ishte sulmuar dhe atë “*...nuk e kam përmend emrin e tij gjatë sulmit që ai ma bëri, ngase jam frikësuar sepse kam dëgjuar se gjatë luftës kur dikujt i ka ndodhur kështu e kur e ka përmend emrin e sulmuesit kanë pësuar keq...*”, që është e kuptueshme për faktin se e njëjta ditën kritike iu nënshtrua një sulmi të papritur nga ana e disa personave.

Edhe pse në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, janë theksuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 par.2 nënpar.2.1 të KPPK-së, megjithatë mbrojtësi i të dënuarit nuk i referohet specifikisht se cila dispozitë konkrete e procedurës penale nuk është zbatuar apo është zbatuar gabimisht, mirëpo nga referati i përshkruar mund të konkludohet se pretendimi bazohet në dispozitat e procesit të identifikimit të të dënuarit, meqë edhe kërkesa fokusohet në këtë drejtim e për të cilat u arsyetuan në pjesën e epërme të këtij aktgjykimi e që në përgjithësi gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të qarta për secilën pikë të aktgjykimit dhe përmes kësaj mund të konstatohet se në të gjitha fazat e procedurës penale të dënuarit i është siguruar një proces i drejtë, i rregullt dhe i paanshëm bazuar në dispozitat e KPPK-së dhe standardet e përcaktuara sipas KEDLNj.

Po ashtu sa i përket pretendimeve për shkeljet e ligjit penal e përkufizuar me dispozitën e nenit 385 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3 të KPPK-së, mbrojtësi i të dënuarit nuk ka specifikuar se cilat janë konkretisht pretendimet e tij pos që ka potencuar faktin se i dënuari sipas aktgjykimit P.nr.440/2011 i datës 19.06.2012, është liruar nga akuza e pastaj çështja është kthyer në rivendosja e pas kësaj është dënuar sipas aktgjykimit të shkallës së parë e që ka shumë pak dallime të gjendjes së fakteve, ligjit penal mes të këtyre aktgjykimeve.

Mirëpo, edhe pse këto pohime qëndrojnë se i dënuari është liruar nga akuza një herë nga gjykata e shkallës së parë, por kjo çështje është kthyer në rivendosje, e që pastaj ka rezultuar se i dënuari, është shpallur fajtor dhe është dënuar, por megjithatë duhet theksuar se aktgjykimi i shkallës së parë i Gjykatës së Qarkut në Pejë i evidentuar P.nr.440/2011 i datës

19.06.2012, ishte anuluar për shkak se ishte aprovuar ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Pejë, andaj edhe pse është evidente se aktgjykimi lirues ka qenë më i favorshëm se aktgjykimi gjykues, megjithatë nuk paraqet shkelje të ligjit penal siç pretendon mbrojtësi i të dënuarit.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit edhe pse nuk i potencon specifikisht, megjithatë nga referati i kërkesës, pretendon për konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, mirëpo këto pretendime nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të dispozitës së nenit 432 par.2 të KPPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkeljen e ligjit penal dhe shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Pml.nr.15/2017, më datë 22.03.2018

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,

Rasim Rasimi